



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

### Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

VMRO- Partia Demokratike për Unitet Nacional

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë.

### Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

Nëpërmjet procedurës së nisur nga viti 2018 partisë politike i ndalohet disponueshmëria e një pjese së pronës, e cila ndikon në vlerësimin e vlerës së një pjese nga prona e patundshmërisë të deklaruar në gjendjen e bilancit. Në librat afariste në vitin 2020, vlera e pronës është rritur për revalorizimin e llogaritur.

### Mendimi i dhënë/përfundimi \*:

Shprehëm mendim me rezervë në lidhje me paraqitjen e të vërtetës dhe objektivitetit të raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

### Rekomandimet kyçe:

Personat përgjegjës të VMRO-DPMNE-së, pas përfundimit të procedurës së iniciuar pranë organeve kompetente, të ndërmarrin masa dhe aktivitete për deklarimin përkatës të pronave të patundshmërisë në gjendjen e Bilancit.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

Të rishikohet dispozita ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt; saktësimi në pjesën e donacioneve nga partia politike, në lidhje me limitet individuale dhe totalit të mjeteve, ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore me të cilën rregullohet mënyra e mbajtjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe rregullimin e mënyrës së pagesës dhe evidentimit të anëtarësisë si burim i financimit.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Është marrë vërejtje të draft-raportit i revizorit të autorizuar shtetëror gjatë të cilës është vlerësuar se i njëjti paraqet arsyetim për gjendjen e konstatuar.

### Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Përgjigja e vërejtjeve është dhënë në bashkëngjitje të këtij raporti përfundimtar.

\* pozitive me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur